



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.7(409)

KORRIK 2022

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

VLERËSIMI


Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe Arteve vlerëson kontributin e Sekretarit të Përgjithshëm të OBVL



**HALIL RAMA
MERR TITULLIN
“AKADEMIK” DHE
PROMOVON LIBRIN
“MAGJIA E FJALËS”**

FAQE 10 - 11

80 - VJETORI



**ÇETAT
PARTIZANE
NË QARKUN E
KORÇËS NË
VITIN 1942**

Prof. Assoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 4 - 5

Në qytetin e lashtë të Prizrenit, më 10 qershor ishte festë e madhe - U PËRKUJTUA NË MËNYRË MADHËSHTORE 144-VJETORI I LIDHJES SË PRIZRENIT

KUVEND PËRFAQËSUES I TË GJITHË SHQIPTARËVE

Zëri i ndërgjegjes

SHPENDI TOPOLLAJ

Halil Rama, qoftë si drejtues i gazetës “Veterani”, qoftë si një nga drejtuesit kryesorë të OBVL - së, ka shkuar përpara: ai ka realizuar bashkëpunim të pandërprerë me veteranët e Kosovës, me luftëtarët e UÇK - së, ka ndriçuar ngjarje të errësuar qëllimisht, dhe ka thënë të vërtetën për figura kryesore të luftës antifashiste që u ndëshkuan rëndë, vetëm pse kërkonin bashkimin e trojeve tona. Shembujt janë të shumtë: qysh nga kujdesi për botimin e veprës së atdhetarit të shquar, Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit Rrahman Parllaku që Kosovën e kishte aq për zemër e deri te filmi dokumentar kushtuar jetës dhe veprës së Fadil Hoxhës...

FAQE 11



• *Përvjetoret e Lidhjes së Prizrenit janë dhe duhet të jenë takime të veçanta të çdo shqiptari me historinë sepse faqja e shkruar më 10 qershor 1878 shënoi fillimin e një epoke të re. Është koha për një lidhje të re që na bën bashkë si dikur paraardhësit tanë nga të gjitha trevat shqiptare*

Nga Bashkim HISARI

FAQE 2-3

PROMOVIMI

“PËR HALIL RAMËN, E PARA ËSHTË SHQIPËRIA”

Me shkrimet e tij për njerëzit që lanë gjurmë të pashlyera në fatet e krahinës apo atdheut, një intelektual i përkushtuar, i kulturuar dhe i ndershëm si Halili, qoftë edhe me ngjyrimet letrare, ka dhënë ndihmesën e tij në saktësimin e historisë

Kadri TARELLI

FAQE 11

TRAJTESA

Sekretari Organizativ i OBVL, Ing. Kolë Dedaj mban Kumtesën “Dëshmorët e rënë gjatë LANÇL”



Xhemal Meçi “Mjeshtër i Madh” & studiues

FAQE 7

SESION SHKENCOR PËR DËSHMORËT E ATDHEUT NË PUKË

HISTORIA

Ngjarje kulmore në historinë e LANÇ

RRAHMAN PARLLAKU **FAQE 6**

LIBRI

Disa të pathëna për mitin e “Shtabit Ndërbalkanik” gjatë Luftës së Dytë Botërore

FAQE 9

99-VJETORI I LINDJES

FLUTURAK ASABELLA, ANTIFASHISTI I ORËVE TË PARA **FAQE 8**

FESTA

Në qytetin e lashtë të Prizrenit, më 10 qershor ishte festë e madhe - U PËRKUJTUA

Kuvend përfaqësues i

Nga **Bashkim HISARI**

Në qytetin e lashtë të Prizrenit, më 10 qershor ishte festë e madhe. Në rrugët e qytetit, për disa ditë rresht, valëviteshin flamujt kuqë e zi me shqiponjën dykrenare bashkë me simbole të tjera kombëtare. Shqiptarët nga të gjitha trojet etnike kishin ardhur për të festuar një ndër ngjarjet më të rëndësishme që ka ngritur përgjithmonë vetëdijen kombëtare shqiptare, 144-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Më 10 qershor të vitit 1878, në Prizren, u mbledhën 110 delegatë shqiptar nga katër vilajetet dhe mbajtën Kuvendin historik me një qëllim të vetëm, t'i bashkojnë trojet shqiptare. Në punimet e Kuvendit të Përgjithshëm të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit udhëhequr nga diplomacia e guximi ushtarak i burrave dhe grave shqiptare, të urtë, të mençur e sy pa pa trembur është ngritur zëri kundër copëtimit të tokave shqiptare dhe ishte vendosur që të krijohet një organizatë me karakter politik e ushtarak, me qendër drejtuese në Prizren dhe me degët përkatëse në krahinat e ndryshme shqiptare. Në këtë mënyrë, sipas historianëve, lindi "Besëlidhja" (itifik) që më vonë u quajt "Lidhja Shqiptare" ose "Lidhja e Prizrenit". Organizata politiko-ushtarake Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në luftë e sipër, u shndërrua në një organizëm shtetëror me administratën, ushtrinë, dikasteret dhe territorin e saj, prandaj dhe gëzon statusin e ngjarjes së rëndësishme në historinë e përpjekjeve të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi kombëtare.

Në manifestimin e organizuar nga Qeveria e Kosovës, merrnin pjesë kryeministri i Kosovës Albin Kurti, kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Lindita Nikolla, ministra, deputetë, kryetarë të komunave dhe bashkive komunale nga Kosova, Shqipëria, Mali Zi, Maqedonia e Veriore dhe Lugina e Preshevës, diplomatë, liderë fetarë e shumë zyrtarë tjerë dhe

Organizata politiko-ushtarake Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në luftë e sipër, u shndërrua në një organizëm shtetëror me administratën, ushtrinë, dikasteret dhe territorin e saj, prandaj dhe gëzon statusin e ngjarjes së rëndësishme në historinë e përpjekjeve të popullit shqiptar për liri dhe pavarësi kombëtare



qytetarë.

ALBIN KURTI: JEMI VENDOSUR NË ANËN E DUHUR TË HISTORISË

Në fjalën e rastit, kryeministri i Kosovës Albin Kurti theksoi se Kuvendi në Prizren nisi si mbledhje e përfaqësuesve të krahinave shqiptare që rrezikoheshin drejtpërdrejt nga pushimi prej shteteve ballkanike të kohës, që shqiptarët nuk i konsideronin si komb. Sipas tij, Kuvendi i Prizrenit ishte kuvend përfaqësues i të gjithë shqiptarëve dhe jo vetëm i popullatës së disa krahinave, shqiptarët ishin

një komb, që do të thoshte se territori ku jetonin u takonte atyre dhe se vetëm ata mund të vendosnin për veten e tyre, ndaj shqiptarët kërkonin vetëvendosje, të drejta të njëjta me kombet e tjerë të lirë të Evropës, theksoi kryeministri dhe nënvizoi se "Lidhja e Prizrenit është një program sepse forcimi i shtetit dhe i sovranitetit është garancia më e mirë që ka një komb për sigurinë e tij, aleancat, zhvillimin ekonomik, bashkëpunimin e gjithanshëm ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen në procese integruese rajonale, kontinentale dhe globale".

Kryeministri Kurti foli edhe për krizën e rëndë me të cilën po përballlet sot kontinenti i Evropës për shkak të agresionit rus dhe luftës në Ukrainë. „Jo shumë larg prej nesh, kombi ukrainas po lufton për ekzistencën, lirinë, atdheun dhe shtetin e vet”, tha ai dhe shtoi se Rusia, në vend që të bashkëpunojë për sigurimin e paqes në botë, po ringjall ëndrrat perandorake të fashizmit e komunizmit sovjetik. „Sot nevojitet solidariteti me viktimën dhe dënimi i agresorit. Nevojitet ndihma ndaj luftës çlirimtare dhe izolimi i agresorit, njëjtë si në vitet 1998-1999 kur NATO i erdhi në ndihmë popullit shqiptar të Kosovës”, tha kryeministri Kurti.

Në fjalimin e saj, kryetarja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Lindita Nikolla tha se Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ishte mision historik kombëtar që themeloi një organizatë poli-

tike e ushtarake, për mbrojtjen e interesave të shqiptarëve, me një qendër drejtuese kombëtare e degë në të gjitha krahinat e vendit, njëherit ishte edhe një shenjë kombëtare që tregoi se interesat atdhetare duhet të mbizotërojnë ndaj interesave politike, fetare a të natyrave të tjera. Ajo nënvizoi se krahasuar me kohën e Lidhjes, sot shqiptarët, nuk janë të injoruar e mohuar. -“Përkundrazi, jemi vendosur në anën e duhur të historisë, duke u bërë partnerët strategjikë më të besueshëm të demokracive të kohës, Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian. Përshpejtimi i integritimit rajonal të vendeve të rajonit. Sot është momenti që Shqipëria dhe Kosova e të gjithë shqiptarët të shndërrohen në një motor të bashkëpunimit dhe integritimit rajonal” tha ajo dhe shtoi se „Shqipëria po mbështet kërkesën e Kosovës për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës dhe këtë po ua kërkon të gjitha shteteve anëtare”.

RËNDËSIA E LIDHJES SË PRIZRENIT PËR MBIJETESËN E LIRINË E KOMBIT SHQIPTAR

Rëndësinë e Lidhjes së Prizrenit për mbijetesën e lirinë e kombit shqiptar, gjatë shënimit të 144-vjetorit të kësaj ngjarjeje historike, para Kompleksit memorial të Lidhjes së Prizrenit e përkujtoi akademiku Pëllumb Xhufi i cili tha se përvjetoret e Lidhjes së Prizrenit janë dhe duhet të jenë takime të veçanta i çdo shqiptari me historinë sepse faja e shkruar më 10 qershor 1878 shënoi fillimin e një epoke të re.

Ai theksoi se në Kongresin e Berlinit më 13 qershor 1875, Fuqitë e mëdha dhe Porta e lartë u mbledhën për të rikonfirmuar mosnjohjen e kombësisë shqiptare dhe për të shpërblyer klientët e tyre ballkanik me copat e territoreve shqiptare. -“Shqiptarët u trajtuan në atë Kongres si relikte të historisë. Në fakt, i vetmi „kujdes” që fuqitë e mëdha treguan ndaj shqiptarëve ishte propozimi i përfshirjes së tyre në sistemin mesjetar, në vend të shtetit kombëtar të shqiptarëve propozuan një zgjidhje primitive për Malësin e mbi Shkodrës. Kjo ishte mënyrë me cinike për t'u mohuar shqiptarëve kombësinë dhe shtetin kombëtar dhe për të rikonfirmuar politikën europiane të ndarjes dhe të përçarjes mes



FESTA

NË MËNYRË MADHËSHTORE 144- VJETORI I LIDHJES SË PRIZRENIT

të gjithë shqiptarëve

- **LINDITA NIKOLLA:** Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ishte mision historik kombëtar që themeloi një organizatë politike e ushtarake, për mbrojtjen e interesave të shqiptarëve, me një qendër drejtuese kombëtare e degë në të gjitha krahinat e vendit, njëherit ishte edhe një shenjë kombëtare që tregoi se interesat atdhetare duhet të mbizotërojnë ndaj interesave politike, fetare a të natyrave të tjera



shqiptarëve duke luajtur me ndarje teritoriale dhe fetare”, tha historiani i njohur, akademiku Pëllumb Xhufi dhe shtoi: -“Këtu vjen roli vendimtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Pjesëmarrja e delegatëve në këtë Kuvend ishte mbarëshqiptare. Organizimi gjithashtu me krijimin e tre degëve të Lidhjes, dega e Prizrenit, ajo e Shkodrës dhe dega e Janinës. Mbi të gjitha, programi ishte një program. Dy ishin detyrat prioritare të përcaktuara nga Lidhja 1. Mbrojtja e territoreve shqiptare dhe 2. Bashkimi i katër vilajeteve shqiptare në një vilajet i vetëm autonom, me ushtri, administratë, shkolla e gjykata shqiptare. Komiteti Kombëtar i Lidhjes së Prizrenit me Haxhi Ymer Paçarizin, Abdyl Frasherin, Suliman Vokshin, Shaip Salihun etj. e shpalli vehtë qeveri të përkohëshme dhe vuri të realizon në praktikë autonomi dhe eventualisht pavarësinë e Shqipërisë”, nënvizoi akademiku Xhufi.

Sipas tij, me Lidhjen e Prizrenit ishte hera e parë që shqiptarët nga të gjitha krahinat, të gjitha besimeve fetare dhe të gjitha shtresave shoqërore u bashkuan rreth qëllimit të shenjë. Përfshirja e intelektualëve patriot i dha luftës së Lidhjes objektiva të qa-

rta kombëtare, krijimin e një shteti të bashkuar kombëtar në kufijt e tij historik dhe etnik të një shteti laik me institucionet të zgjedhura nga populli, me shkollë, arsim dhe kulturë kombëtare, të një shteti orijentuar nga Europa dhe vlerat e saj.

Për fat të keq, nënvizoi akademiku Xhufi idetë e tilla nuk hodhën rrën-

jët në kryeqytet Europiane dhe shqiptarëve u desht të luftonin vetëm dhe të realizonin shtetin e tyre më vitin 1912, por me humbje të mëdha kohe, njerzëzish dhe territore. Sipas tij, historia nuk mbaron aty. Porosia e madhe e Lidhjes së Prizrenit mbetet për të plotësuar. Ajo vazhdoi të mobilizoj brezet e rinj që me gjak dhe sakrificat të panumërta mundësuan që pikërisht sot ne këtu të mblidhemi për të përkujtuar 144 vjetorin e saj në Prizrenin e Kosovës së lirë, të vetëdijshëm se duhet të punohet dhe luftohet edhe më shumë për të realizuar ato që vendosën në Prizren në vitin 1878 ata shqiptarë të mirë trima të ditur që ndryshuan historinë, përkujtoi akademiku Pëllumb Xhufi.

Kryetarët e komunave shqiptare të rajonit që zhvilluan një takim simbolik para Kompleksit memorial të Lidhjes së Prizrenit, për të shënuar përvjetorin e Kuvendit të Prizrenit që në historinë e popullit shqiptar ishte tubim më i organizuar politik pas Lidhjes dhe themelimit të Kuvendit të Lezhës në vitin 1444, theksuan se Lidhja mbetet frymëzim i shumë gjeneratave të shqiptarëve. Njëherësh ata bënë thirr-

rje për nevojën e unitetit dhe shtim të bashkëpunimit të ndërsjellë.

ERION VELIAJ: LIDHJE MODERNE E KRYETARËVE TË KOMUNAVE MBARËSHQIPTARE

Kryetari i Tiranës, Erion Veliaj, takimin simbolik e quajti lidhje moderne e kryetarëve të komunave mbarëshqiptare për t'a shënuar 144-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit. “Në këtë shtëpi historike besoj fort që ky takim i sotëm e ka edhe përmasën e vet historike”, tha Veliaj.

“Dua ta quaj një lidhje moderne të Prizrenit. Një lidhje të re që na bën bashkë si dikur paraardhësit tanë nga të gjitha trevat shqiptare. Sigurisht koha është tjetër. Situata është krejt tjetër nga ajo e 144 vjetëve më parë. Ne nuk jemi në luftë. Jemi në paqe. Nuk kemi rreziqe territoriale, synimi ynë nuk është vendosja e kufijve. Përkundrazi, është shkrirja e kufijve dhe rritja e bashkëpunimit mes vete”. Veliaj tha se ndonëse s'ka luftë, ka besë mes shqiptarëve për vijim të bashkëpunimit dhe ruajtjes së trashëgimisë. “Ne duam dhe duhet t'i japim dhe të marrim nga njëri-tjetri.

Ne duhet të bëhemi bashkë, për të bërë diçka, për të bërë punë të mira së bashku”, tha pos tjerash kryetari i Tiranës Erion Veliaj.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, vlerësoi se bashkëpunimi i pushteteve lokale mund të shtrihet në fusha të ndryshme e veçanërisht në aktivitete kulturore. Ai pati disa kërkesa për Shqipërinë, që të ndihmojë Kosovën në rrugën e saj euroatlantike. “Si kryetar i kryeqytetit të Kosovës po bëj thirrjen time publike që Shqipëria të përdorë zërin e saj për të folur me gojën mbarë shqiptare këtë muaj që shqiptarët kryesojnë në OKB. Është lajm i mrekullueshëm fakti se në agjendën e Këshillit të Sigurimit do të hapet këto dite çështja e përjashtimit në masë të shqiptarëve nga listat



STUDIMI

Në kuadrin e 80 vjetorit të formimit të çetave partizane

Çetat partizane në Qarkun



Prof. Assoc. Dr. Bernard Zotaj

Ç'FARË PËRFAQËSONTE ÇETA PARTIZANE?

Konferenca e Pezës 1942, me prirje të ndryshme politike, hodhi për diskutim çështjen e luftës së bashkuar të popullit shqiptar kundër pushtuesit për çlirimin e vendit. Ndaj dhe u vendos se duheshin ngritur e krijuar forcat e domosdoshme luftarake, për vazhdimin të luftës së popullit shqiptar, thuhej në rezolucion. Që më parë ishte parashikuar dhe udhëzuar që krahas njësiteve guerile, të vijonte procesi i formimit dhe i formacioneve të tjera më të mëdha të domosdoshme për luftën dhe në radhë ishte formacioni i çetave partizane. Ndaj dhe udhëzohej se çështjen e guerileve të mos e kuptojnë cekët, atje ku ka mundësi të formohen çetat partizane.

Formimi i çetave partizane kishte një rëndësi të veçantë, sepse ishte i lidhur me krijimin e bazave të luftës në fshat, ku ishte përqëndruar pjesa më e madhe e popullsisë së vendit. Në këtë mënyrë me krijimin e tyre përfshihej një masë e madhe njerëzish, do rritej dhe objekti i goditjes dhe dëmtimit të armikut. Në këtë formacion luftarak do formoheshin dhe kaliteshin luftëtar dhe kuadro të formacioneve të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kështu çetat do shndërroheshin në bërthama luftarake rreth të cilave do ngriheshin formacione lufte të reja.

Formimi i çetave ishte traditë e herëshme dhe e pasur luftarake e popullit, e shfrytëzuar me mjaft efekt dhe originalitet. Çetat në Shqipëri shfaqen qysh në vitet e luftërave të Skënderbeut kundër pushtuesve osmanë. Veprimtaria e çetave në Shqipëri është e dukshme dhe në periudhën e parë të Rilindjes, pas Pashallaqeve, kurse pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit rishfaqen më të plotë. Të tilla ishin çetat e Bajo e Çerçiz Topullit, Mihal Gramenos, e Themistokli Gërmenjit, Kajo Babienit e Sali Butkës etj., në pragun e fitores së Pavarësisë. Organizimi dhe veprimet luftarake me bazë çetat u dukën në Shqipëri sidomos në epopenë e Luftës së Vlorës, te Dibrës dhe të Koplikut në vitin 1920 kundër pushtuesve imperialist

italian. Këto çeta u krijuan në bazë fshati, kra-hine e komandoeshin nga fshatarë trima e me përvojë luftarake të pasur.

Çetat partizane ishin në gjëndje të kryenin veprime luftarake të mirëfillta, të fuqishme dhe në shkallë të lartë, kishin forca dhe armatime të shumta, drejtim të qëndrueshëm, të centralizuar e kolegjal. Çetat e shtrinin veprimtarinë luftarake në një zonë me rreze të gjerë dhe me koncepte të qarta e të plota luftimi, ishin të lehta, të shpejta e kompakte dhe kishin pavarësi veprimesh. Ato bashkëvepronin me njëra-tjetrën për aksione të përbashkëta luftarake. Çeta ishte një formacion luftarak mjaft i përshtatshëm për të vepruar me taktikën e luftës partizane. Lufta e tyre kishte bërë për vete masa të shumta fshatare dhe të përgatitur për luftën e armatosur çlirimtare. Mbi këtë themel të sigurtë çetat partizane nisën të ngrihen e të shumohen me shpejtësi.

Çetat partizane dhe vullnetare territoriale u organizuan me një shpërndarje gjeografike, në të gjitha krahinat e vendit duke mundësuar goditjen dhe dëmtimin e armikut kudo që ai ishte vendosur ose lëvizte. Burimi kryesor njerëzor për çetat u bë fshati. Ishin fshatarë të vetmuar apo grupe fshatarësh të dalë maleve, të cilët u futën në çetat partizane në saj të punës sqaruase e bindëse që ishte bërë paraprakisht me ta, në bazë.

Drejtimin ushtarak të çetës e kryente komanda (komandanti dhe komisari) ose e thënë ndryshe shtabi i çetës. Piramida e shtabit të çetës, veç komadës, përfshinte edhe zëvendëskomandantin, zëvendëskomisararin dhe intendentin, kur kishte. Ishin komandanti dhe komisari që drejtonin së bashku tërë veprimtarinë e çetës.

Luftëtarët e çetave partizane mbanin në kapele yll të kuq me pesë cepa dhe nisën të quheshin partizanë. Ideja e yllit të kuq me pesë cepa, ishte hedhur e konfirmuar qysh në tryezën e diskutimeve të Konferencës së Pezës. Aty ishte pranuar pa debat se çetat partizane që luftojnë me flamurin e Skënderbeut të mbajnë si shenjë dalluese shenjën partizane flamurin kuq e zi me yllin e kuq dhe çetat vullnetare si shenjë dalluese flamurin kuq e zi. Mjaft çeta partizane, drejtues dhe pjesëtar të tyre mbanin në kapele ose në të majtë të jakës së xhaketës një shqi-

ponjë të zezë, dykrenare me një yll të kuq me pesë cepa sipër saj. Mjaft patriot si Myslym Pezës, Mustafa Xhanit (Baba Fajë Martaneshit), Riza Kodhelit, shquhen më dukshëm, etj. Për këtë dukuri Myslym Peza ka shkruar sinqerisht se, me ardhjen e komunistëve në çetë filluam ta quanim veten partizanë.

Ndryshe nga njësitet guerile, luftëtarët e çetave partizane ishin efektivë, bënë jetë të përhershme të grupuar. Ata ishin luftëtarë profesionistë, por me ndryshim thelbësor se nuk paguheshin. Në këtë mënyrë, duke qenë të grupuar në çdo çast, ishin aktivë dhe të gatshëm për të kryer veprime luftarake në çdo kohë. Hyrja në çetë ishte thellësisht vullnetarë, por largimi prej saj nuk ishte më vullnetar. Largimi nga çeta konsiderohej dezertim, tradhëti. Ndryshe lufta e shenjtë për çlirim do të degradohej keqazi. Të para në këndvështrim ushtarak çetat ishin formacione luftarake të armatosura, fillestare, të madhësisë taktike dhe me një organizim ushtarak të mirë e solid. Ato u krijuan për çlirimin e fshatrave e të krahinave të vendit nga pushtuesit fashistë, për të goditur garnizonet e për të organizuar prita, kurthe, etj., si dhe për të përgatitur forcat luftarake për formacionet dhe veprimet luftarake të ardhshme.

Një problem tjetër, sidomos për luftëtarët që vinin rishtaz në çetat partizane përbente përdorimi i armëve. Për të përdorur me efektivitet këto armë, partizanët aftësoheshin gjatë stërvitjeve që bënin në kohën e pushimeve (pas luftimeve) dhe gjatë aksioneve. Një shembull të tillë për-bën çeta e Pezës, ku stërvitja kryhej mes të tjerash për njohjen e armëve si dhe për shënjim e qitje me to. Në një farë mase, po në këtë mënyrë u zgjidh edhe problemi i municioneve. Çdo partizan në këtë çetë kishte zakonisht në rastin më të mirë 50-60 fishekë dhe 1-2 bomba dore. Përmirësimet graduale në armatime ndikuan në një farë mase që në skuadrat e disa çetave partizane të krijoheshin grupe prej 3-4 vetësh të cilët kryenin detyra sulmi, mbështetje ose bllokimi.

ÇETAT PARTIZANE NË QARKUN E KORÇËS GJTË VITIT 1942

1. **Çeta e Gorës.** Më 27 prill 1942 në katundin Grabovicë u formua Çeta e Gorës me 30 luftëtarë. Sabri Kamber Ruçi ishte komisar



STUDIMI

e Korçës në vitin 1942

i çetës partizane Gorë-Opar, një ndër 200 komunistët e parë. Bazën e kishte në krahinën e Gorës, por dhe ka vepruar në fushës e Korçës, në fshatrat Dushar, Lozhan, etj. Zgjeri zonën e veprimeve dhe kaloi në krahinën e Mokrës, ku luftoi për shpartallimin e forcave fashiste të postës së karabinierisë në Moçan. Më 16 janar 1943, bashkë me çeta partizane të qarkut të Korçës, mori pjesë në aksionin e Voskopojës. Më 31 janar 1943, partizanët e çetës së Gorës, në bashkëveprim me partizanë të tjerë të Korçës zhvilluan luftime kundër garnizonit armik të Snosmit. Çeta më 16 maj 1943 mori pjesë në çlirimin e qytetit të Leskovikut.

2. Çeta e Mokrës. Më 27 qershor 1942 me ilegalët e parë të qyteteve të Korçë e Pogradecit dhe të krahinës së Mokrës u krijua çeta partizane që mori emrin e krahinës ku vepronte. Komandanti u caktua Reshit Çollaku dhe komisar Pilo Peristeri. Çeta veprroi në krahinën e Gorës, të Oparit dhe mori lidhje e bashkëveproi me forcat partizane të Skraparit. Çeta e Mokrës bënte në zonë punë propagandistike për sqarimin politik të popullsisë, paralajmëroi xhandarët për tu larguar nga krahina e Mokrës dhe Gorës, për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare, për krijimin e njësiteve partizane nëpër fshatra, për shpërndarjen e të dhjetave në popull, pastroi zonën nga postat e karabinierisë italiane dhe zhvilloi aksione kundër milicëve mercenarë dhe fashistëve italianë. Në gusht 1942 çeta shkatërroi urat në rajonin e Prrenjasit. Në shtator 1942, së bashku me çeten e Gorës, kreu aksionin e Grabovicës dhe në tetor 1942 të Prrenjasit, ku dëmtoi disa maqina. Më 16 janar 1943 luftoi në Voskopojë dhe më 31 mars luftoi në Snosmit. Më tej kreu aksione në minieren e Çervenakës. Mbi bazën e çetë u krijua Batalioni i Mokrës, i cili mori emrin Batalioni "Reshit Çollaku".

3. Çeta e Moravës. Çeta e Moravës u formua me 10 korrik 1942, në afërsi të fshatit Hoçisht të Devollit. Njihet dhe me emrin çeta e Devollit, me partizanë dhe komunistë të ardhur nga qyteti i Korçës dhe fshatrat e Devollit. Komisar u caktua Raqi Themeli. Partizanët e çetës së Moravës zhvilluan punë propagandistike, çarmatosën postët e xhandarmërisë, etj. Në fillim të gushtit 1942, azgjësoi një grup me milicisë fashistë në afërsi të fshatit Gjyras. Në shtator 1942 njësit i çetës azgjësoi një spiun të pushtuesve fashistë. Partizanët e çetës hapën depot e armikut dhe i shpërndanë popullit drithra. Në nëntor dhe dhjetor 1942 çeta e Moravës shpartalloi postën armike të Bozhigradit dhe të Braganit. Më 20 shkurt 1943 zhvilloi aksionin në fshatin Pojan me një grup ushtarë italianet që po ndreqnin linjën telefonike. Humbja e parë dhe më e rëndë që ka patur çeta e Moravës gjatë luftërave të saj ishte më 7 marsit 1943. Rreth 500 fashistë italianë rrethuan në Hoçisht një pjesë të saj. Në luftimet që u zhvilluan për të dalë nga rrethimi, ranë partizanët Fuat Babani, Demir Progrid dhe Avdulla Progrid. Çeta e Moravës ishte bazë për krijimin e Batalionit "Fuat Babani".

4. Çeta e Kolonjës. Çeta e Kolonjes u formua më 24 korrik 1942 në fshatin Kozel. Baza e



saj ishin ilegalët e parë të krahinës, të cilët kishin krijuar njësitin partizan. Komandant u caktua Petrit Dume, komisar Orhan Frashëri. Në përbërje të çetës u futën kryesisht fshatarë patriotë të rrethit të Kolonjës dhe studentë të krahinës. Zona e veprimeve luftarake ishte krahina e Kolonjës. Më 2 tetor 1942 partizane të çetës Kolonjë, së bashku me çetën e Gorës, luftuan në rrugën Bellovodë-Vithkuq kundër një grupi milicësh fashistë. Çeta luftoi kundër postave të karabinierisë fashiste, të vendosura në katundet Shënmërtir, Shtikë, Gërmenj, Arrëzë dhe Kovaçisht. Më 28 dhjetor 1942, në bashkëpunim edhe me çeten e Skraparit, ajo goditi postat e milicisë dhe të karabinierisë, në Barmash. Më 18 shkurt 1943, çeta sulmoi një autokollonë armike në afërsi të urës së Helmësit. Më 16 maj 1943 çeta e Kolonjës, së bashku me çetat e tjera të qarkut të Korçës mori pjesë në Luftën e Leskovikut. Ajo organizoi një pritë tek Ura e Shalësit kundër një autokollone armike me 43 kamione dhe dy autoblanda. Më 20 maj 1943 partizanet e çetës hynë në përbërje të Batalionit "Hakmarrja".

5. Çeta e Oparit. Çeta e Oparit u krijua më 17 nëntor 1942 në katundin Lavdar. Komisar u emërua Skënder Çaçi. Ajo veprroi kryesisht në Oparin e Sipërm, duke agjituuar për zgjerimin e luftës dhe për mobilizimin e popullit në radhët e luftëtarëve të lirisë. Në krahinë ajo hapi depot me drithë që armiku kishte grumbulluar nga të dhjetat dhe ja shpërndau popullit, ndihmoi popullin në ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare dhe luftoi kundër sipunëve. Më vonë ndërmoi veprime luftarake kundër postave të karabinierisë, milicisë fashiste dhe rojeve të financës. Në Luftën e Voskopojës më 16 janarit 1943, ajo

bashkëveproi me çetat e tjera partizane, rrethoi garnizonin armik deh e azgjësoi atë. Në luftën e bërë më 27 janar 1943 në Snosmi të qarkut të Elbasanit, Çeta e Oparit, së bashku me forca të tjera partizane të qarkut, shpartalloi krejtësisht garnizonin fashist italian. Më maj 1943, me zgjerimin e radhëve partizane, me çetat e Oparit dhe të Gorës u formua Batalioni "Ali Kelmendi", i cili më vonë u quajt Batalioni Gorë-Oparë. Në tetor 1944 Batalioni u inkuadrua në radhët e Br. IX S.

6. Çeta e Vithkuqit. Çeta e Vithkuqit u formua më 27 nëntor 1942 dhe veprroi kryesisht në Vithkuq dhe në rrethin e Kolonjës. Ajo ka bërë punë agjitative për ngritjen e këshillave nacionalçlirimtare në fshatra dhe ka zhvilluar luftime në rrugën Përmet-Leskovik, në afërsi të katundit Çarçovë. Në aktivin e çetës bëjnë pjesë atentatet kundër spiunëve në shërbim të fashizmit, prerja e linjave telefonike në fillimin e vitit 1943 në drejtimet Vithkuq-Korçë e Qarr-Leskovik, hedhja në erë e urave të Bellovodës, Barmashit, etj. Luftime zhvilloi në rrugën automobilistike Vithkuq-Leshnjë më 10 shkurt 1943, ku partizanët në pritë, zunë grup xhandarë dhe milicë. Më 18 shkurt 1943, çeta, e vendosur në rrugën automobilistike Qarr-Ersekë tek ura e Dukës, i zuri pritë një grupi me forca fashiste. Lufta më e përmendur është Lufta e Leskovikut. Në qershor 1943 partizanët e çetes së Vithkuqit hynë në përbërje të Batalionit "Qamil Panariti".

Çetat partizane në Qarkun e Korçës kanë luajtur një rol të dukshëm në ngritjen dhe zhvillimin e luftës së armatosur të popullit shqiptar dhe ka qenë burim frymëzimi, mbështetje dhe insiprimi në ngritjen e farmacioneve të mëdha si batalione, brigada sulmuese dhe divizione.

HISTORIA

Ngjarje kulmore në historinë e LANÇ

RAHMAN PARLLAKU

Viti 1943 shënoi rritje në përmasa të mëdha të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në gjithë vendin ishin krijuar njësite guerile, çeta e batalione partizane. Luftimet zhvilloheshin jo të veçuar nga çetat e batalionet, por të përbashkëta e të koordinuara brenda qarkut.

Po në korrik të atij viti, filluan të zhvilloheshin veprime luftarake të përbashkëta edhe në mes qarqeve të ndryshme, siç ishin luftimet e Përmetit, ku morën pjesë forcat e Gjirokastrës, Korçës e Beratit. Shtimi i radhëve të Ushtrisë partizane, çlirimi i krahinave të ndryshme, jehona e luftës së përhapur në të gjithë vendin u ndien edhe në botën e jashtme dhe u vlerësuan nga Fuqitë e Mëdha të Aleancës Antifashiste.

Ata e njohën Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, dërguan përfaqësuesit e tyre pranë Shtabit të Përgjithshëm, Zonës së Parë Operative, qarqeve e njësive që ta ndiqnin nga afër e ta ndihmonin atë. Ky nivel i ri i Luftës Antifashiste kërkonte që Ushtria të kishte një strukturë të re organizative, të njëjtë si për repartet sulmuese dhe territoriale, ashtu edhe për krijimin e njësive taktiko-operative për veprime në të gjithë vendin. Rritja sasiore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE

Në këtë shkrim nuk kam marr për sipër të flas gjatë për fillnisjen dhe vazhdimësinë e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, pasi kjo u takon historianëve, por të përkujtoj e të them diçka për një nga datat më të rëndësishme në historinë e Ushtrisë Shqiptare, atë të krijimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjykoj se kjo datë do të zërë vendin e merituar në analet e historisë së kombit tonë.

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm, 79 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqendruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i pajisur me kulturë ushtarake.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative, që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës së kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëhershme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuar të vepronin në gjithë hapësirën e territorit të vendit dhe forcat



territoriale, që vareshin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliruara, qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj.. Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitë e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësive e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Kjo iniciativë ishte mëse e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt, mjete teknike të ndërlydhjes e drejtimit mungonin, kryesisht, komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

PARTIZANËT PËRBALLUAN VËSHTIRËSI MBINJERËZORE

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë kushtet tepër të vështira në të cilat vepronte dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgatiti e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinën ushtarake, të kombinimit të disiplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj.. Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhëniet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake

që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgatitja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitë e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballojnë vështirësi, do të thosha mbinjerëzore. Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-'44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitë e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm, që e befaso i keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

NDRYSHIMET ORGANIZATIVE ISHIN TË KARAKTERIT OPERATIVO-STRATEGJIK

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësive të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në hapësira të mëdha të territorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore.

Në këto kushte, Shtabi i Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësive që ishin të karakterit operativ-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve

dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin Antifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitë operative strategjike. Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqendroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të Kryeministrit, të ministrit të Jashtëm etj.. Por siç dihet, ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgatitura, si dhe komandat e njësive e të reparteve.

Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit '44, duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimit e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi që kish marrë lufta, shtimi e forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj, Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish-Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇI, për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të pasur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu, u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në këshilla e kishin shqiptarët. Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kudër Aleatëve. Në këtë aspekt, është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish-Jugosllavi, për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

**Ish- Kryetar i OBVL, gjeneral-lejtënant Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit (Marrë nga libri "Një shekull në memorie")*

TRAJTESA

Sekretari Organizativ i OBVL, Ing. Kolë Dedaj mban Kumtesën “Dëshmorët e rënë gjatë LANÇL”

SESSION SHKENCOR PËR DËSHMORËT E ATDHEUT NË PUKË

Xhemal Meçi
“Mjeshtër i Madh” & studiues

• DR. Gjergji VELO: “Ky sesion shkencor do të mbetet në Historinë e Organizatës sonë, si i pari i këtij lloji kushtuar Dëshmorëve të Atdheut”

Muzeu Historik i Qendrës Kulturore i Bashkisë Pukë, në bashkëpunim me Organizatën e Dëshmorëve të Atdheut, Dega Pukë dhe të Komitetit të Veteranëve të LANÇL, Dega Pukë, organizoi, sesionin e parë shkencor “Dëshmorët e Pukës dhe mesazhi i tyre”, në kuadrin e 144 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (të 10 qershorit 1878) si edhe të 110-vjetorit të Pavarësisë, më 9 qershor 2022 në bibliotekën e Pallatit të Kulturës “Ndue Shyti” Pukë, ku morën pjesë familjarë të Dëshmorëve të Atdheut dhe intelektualë e qytetarë të tjerë të Pukës, Shkodrës, Tiranës etj. Gjithashtu të ftuar nderi ishin edhe : Dr. Gjergji Velo, Kryetari i Kryesisë së Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut të Republikës së Shqipërisë dhe dy Nënkretarët : z. Shaqir Vukaj dhe Kujtim Alia.

Kryetari i Bashkisë Pukë, z. Gjon Gjonaj përshëndeti të pranishmit dhe, në veçanti, Kryetarin dhe dy Nënkretarët e Kryesisë së Organizatës së Dëshmorëve të Atdheut të Republikës së Shqipërisë: Dr. Gjergji Velo dhe Shaqir Vukaj e Kujtim Alia, të cilët na nderuan me praninë e tyre, duke vlerësuar kaq seriozisht këtë veprimtarë në nderim edhe të Dëshmorëve të Atdheut të Pukës, rënë për Liri e Pavarësi brenda e jashtë rrethit të Pukës, si edhe në mbrojtje të Trojeve të Atdheut deri në Plavë e Guci, Kaçanik e Prizren, Gjakovë e tjerë. Njëkohësisht shprehur respektin e Tij për të gjithë të pranishmit, sidomos familjarët e Dëshmorëve të Atdheut të Rrethit Pukë e më gjerë, të cilët tregohen të gatshëm në çdo përkujtim e festim që organizon Bashkia Pukë si për 5 Maj dhe të gjitha ngjarjet e tjera historike të Pukës, si 10 qershorin, 20 nëntorin si edhe 28 e 29 Nëntorit etj. Ky sesion shkencor kushtuar Dëshmorëve të Atdheut, numëri i të cilëve, të shpallur Dëshmorë të Atdheut si Pukë rreth i kalon 84 të rënë (Ing. Kolë Dedaj-“Në Panteonin e Lirisë,” Tiranë “ , 2018,f. 75-77) Ky numër u bë i ditur në saj të përpjekjeve të pareshtura të studiuesit të zellshëm ing. Kolë Dedaj me hulumtimet në arkiva

Në vazhdim të programit u mbajtën kumtesat: Xhemal MEÇI - Dëshmorët e rënë në Luftë për Liri e Pavarësi. Gjaku i Dëshmorëve ka rrjedhë prej shekujsh për Liri e Pavarësi dhe Mbrojtjen e Trojeve Arbërore, prandaj sillet në memorije si model heroizmi OSO KUKA, që aq madhërishtë e ka dhënë Fishta të“LA-HUTA e MALCISË,vepren e Tij legjendare si shqiptarit i ka pasë hije në shekuj: “ Aman falë i kjosim Zotit,/ kur i ka dhanë zjarrë barotit:/ Se ç’ asht dridhë Vranina Shkret!/se ç’ a’ hedhë kulla përpjet !/ sa dhe liqeni ka gjimue!./...!.”



Një prej trimave të Oso Kukës që dha jetën në atë kullë baruti ishte edhe :”... Çoku i Kolë Mar’Dinit prej Kabashit t’ Dukagjinit.(Pukë) / trim i çartun / trim si zanë!” Kështu edhe Zenel Mustafë Aga i lballës me Marash Markun e Frrok Kolë Gjergjin. Dëshmor i Atdheut, drejtues i Shtatë Bajrakëve të Pukës gjatë Kryengritjes së Përgjithshme, 1912, përkrahës i Bajram Currit e Hasan Prishtinës, pjesëmarrës në Besëlidhjen e Shkupit gusht 1912. Gjatë kryengritjes për Çlirimin e qytezës së Pukës ranë Dëshmorë Jak Mark Ndreca e Mëhill Marash Përvoci prej Qelze (ende të pashpallur zyrtarisht), si edhe Keqan Qerimi i Trunit i Shpallur Dëshmor i Atdheut. Ndër Dëshmorët e parë të Kryengritjes së përgjithshme 1910-1912 kanë rënë: Mark Deda i Belshinave, Berishë me të dy djemtë e Tij- Mëhillin e Ndoc Mar’Dedën, i kënduar në këngë edhe në ditët tona, sidomos në burgjet serbe prej shqiptarëve të burgosur. Prandaj në Tiranë e Prishtinë ka rrugë me emrin e Tij, kurse në Pukë ende jo, kur sheshit të vogël në perëndim të Shkollës 9-vjeçare “Migjeni” fare mirë mund t’i vihet emri : “Sheshi Ndoc Ma’Deda. Më 1912 ranë Dëshmorë edhe Frrok Kolë Gjergji i Qerretit të Vogël dhe Ndue Marku i Midhës. “ Ai Ndue Marku trim dai, s’e ka Midha shojn e Tij/.

Shoqi i ti kërkund s’a gjetë, pesë asker i ka vra vetë!” Hulumtimet vazhdojnë për Dëshmorët të tjerë , si: Derman Aga e Kadri Sokoli të lballës rënë në mbrojtje të Plavës e Gucisë. Më 1918 ra Dëshmor i Atdheut Sali Tahiri, “Krisi pushka, ushtoi Drini:/ke ka vra Salih Tahiri!” Kështu Zekë Nikollë Curri e Prengë Curri me Nemceli. Çup Qafa Fushë- Arës; si edhe Mustafë A. Brahaj rënë në luftë me ushtrinë Serbe, shpallur Dëshmorë të Atdheut.

Kundër pushtimit Serb nëntor 1912 u ngrit i tërë Bajraku i Malziut, siç e thot edhe kënga: “ kush e filloi Luftën me Serbi !?/ Hoxhallarët e Malitzi !/

Osman Hoxha past rahmet!/ për vend t’ vet paska dekë!./... Zmail Arifi ish kanë djalë , N’ istikam kur ka hi,20 çafira (serb) i ka gri!?...Atje n’ Pistë, ni shpat mali Nam po ban Halil Hasani, Topin dardhe e ka mbarue,/ 12 rrahë ia pas-ka vue / Tri here topi ka ushtue!/ Drini e mali kanë gjimue!... U ndal serbi me ushtri,/ deri sa topi ma s’a ndi? Por asht ndi në Histori!... Halil Hasani Dëshmor ka ra,/ tuj luftu ballas me shkja!!/ Edhe FLeti u ngrit burrë e grue! “ Me ksi djemsh që na I ka Fleti s’i ka Krajl s’i ka Mbreti, s’i ma Toka s’ i ma Detil!/Dymijë vetë komitë kanë dalë, hovin serbit ja kanë ndalë ./Kur ka ba me dredhue n’ prrugoskë dymijë janë shue!” Edhe në Shkodrën e rrethuar prej ushtrisë serbe e malazeze 400 burra nga Puka, të udhëhequr nga Mustafë agë Kryeziu i kanë shkuar në ndihmë Shkodrës, ku luftuan me heroizëm derisa kanë rënë Dëshmorë : Kurt CINA e Rexhë Adem BACI nga Meçja e Kabashit dhe Dem Ismail IBRAHIMI i Rrapës, siç do të binë Dëshmorë të LANÇL, nëntor 1944 nga ajo familje edhe Ismail Shaqir Ibrahimimi e Kadri Isuf Ibrahimimi. Shumë Dëshmorë të tjerë janë të pastudiuar dhe për pasojë të pashpallur. Disa për mos interesimin e familjarëve.

Dëshmorët e rënë për Mbrojtjen e Atdheut i kumtoi Alban DOÇAJ. Një nga Trimat Pukas prej Micoi, që luftoi trimërisht derisa ra Dëshmor në mbrojtje të Atdheut ishte Mehmet Ibrahim Muslia (1925-1949), në moshën 24 vjeçare, kur Ushtria Greke, 1949, donte të godiste prapa shpine forcat komuniste, pozicionuar në Gramoz, sulmuan përmes kufirit Shqiptar. Atëhere Kufiri Shqiptaro-Grek u ndez krejt flakë . Artileria e rëndë e ushtrisë greke godiste çdo pllëmbë toke të kufirit shqiptar, sa gjëtimi i topave të rëndë grek dëgjohej jo vetëm në Tiranë, por deri në Pukë e në Meçe.

Në ato luftime u dallua së tepërmi qëndresa Atdhetare e Ushtrisë Popullore Shqiptare, ku u shquan edhe ushtarët rekrut Pukas, që nuk tërhiqeshin në pozicionet e brendëshme më të fortifikuara, se u dukej tradhti, aq sa forcat disiplinore ua kanë hequr mitralozat nga duart,si: Gjon Prendit prej Kabashi, Rustë Rexhep Alisë së Qerretit, Mark Nd. Mardedit të Kryeziut. Vetë udhëheqja më e lartë qeveritare e asaj kohe i ka vizituar në spital, kur po u kuronin plagët. Më pas i dekuruan me Medalje trimërie dhe Gradime (dy të parët oficer,Aspiranta), ndërsa Marku, nënoficer, kapter, duke u kthyer në fshatrat e tyre si heronj. Edhe Mehmet Muslisë iu bë një varrim prej Heroi në Vidovë, Blinisht, ku pat shërbyer ushtar.

Edhe heroizmi i kapitenit Bardhok D. JAKU,1958, kufi, Tropojë dha jetën në mbrojtje të kufirit të Atdheut. Kíshte rënë borë e madhe, por kufiri mund të kalohej prej diversantave serb, prandaj mori automatikun dhe pa trazuar ushtarët filloi të ndiqte vijën kufitare. Por pa pritmas u shkëput nga mali bora e madhe duke krijuar një ortek stërmadh, i cili e këputi përmes kapitenin trim B. D. JAKU . Rrethi Pukë në vendlindje, Gojan, për ta vlerësuar e përkujtuar më 1958 i ngriti lapidarin, dhe shkollës iu dha emri i Tij. Por këto përkujtime u fshinë më vonë me pretekste pronësie toke etj. Po pushteti vendor i Gjeganit pse heshti!?!

Kumtesën “Dëshmorët e rënë gjatë LANÇL”, Ing. Kolë Dedaj e ka grupuar në të rënë brenda rrethit Pukë deri në kufijtë jugor, si edhe në Kosovë, ku ra Dëshmor Shaban Halil Uka, 7 shtator 1943 për çlirimin e Gjakovës; kurse Ndue D. Gjoka më 11 dhjetor 1944 bie Dëshmor në Deçit të Jugosllavisë, kurse Ukë Neziri, më 1944 në kampin gjerman të shfarosjes në Aushviç, Poloni. Pjetër Prend Jaku i Bugjonit partizan i Çetës së Devollit, ku qe ushtar bie duke luftuar heroikisht për çlirimin e Ersekës; Dodë Mark Lleshi i Kryeziut bie Dëshmor duke mbrojtur partizanin e Br. XXII- S. Halil Çelë Terbuni bie duke orientuar partizanët e Br. XXII- S drejt pozicioneve të një skuadre gjermane mbi Pezhve, Pukë; Pjetër Dedë Alia në Shkodër, 1944. Ndërsa në mbrojtje të fshatit Qerret i Epër binë Dëshmorë më 4 nëntor 1944: Ymer Brahim Çoba, si edhe nipi i Tij, Zenel Kadri Çoba, 1950; Zojë I. Djaloshi, Bajram Islam Toska, Rustem Ramadan Toska. Ali Bytyçi, rënë nga sëmundja gjatë aktiviteteve kushtuar LANÇL, 1942- ‘44: Dëshmori i parë i LANÇL ka rënë duke luftuar me armë në dorë kundër milicisë fashiste në Kryezi, qershor 1943 qe i riu Nikollë Memë Çuku i Oroshit të Kryeziut, Pukë.

Rasim Cina, Kryetari i Org. Dëshmorët e Atdheut, Dega Pukë doli me propozime konkrete për emërtime rrugësh e sheshesh etj. me emra Dëshmorësh, kur në Pukë janë dhënë fare pak. Këtë kërkesë e mbështeti edhe Kryetari i përgjithshëm Dr. GJ: Velo, I cili theksoi “ Se ne u kemi borgji tërë jetën për t’i përkujtuar e respektuar dhe prapë nuk po bëjmë aq sa duhet.” Duke vlerësuar sesionin shkencor la porosi që të bëjmë më shumë me veprimtari të tilla shkencore; duke i përfshirë të gjithë Dëshmorët që ka Puka, dhe nuk keni pak, po mbi 84.; por hulumtoni për më shumë. Sesioni u mbyll me një drekë pune, ku u bënë sqarime dhe u shtruan detyra për të ardhmen.



DITËLINDJA

99-VJETORI I LINDJES

Fluturak Asabella, antifashisti i orëve të para

Fluturak Avdyl Asabella lindi dhe u rrit në fshatin Vinçan të Rrëzës së Korçës. Ishte vetëm 16 vjeç kur Shqipëria pushtohej nga fashizmi italian, megjithatë e shohim pjesëmarrës në demonstrimet e patriotëve korçarë më 5-6 prill 1939 duke kërkuar armë për rezistencë ndaj pushtuesit. Plot zjarr dhe energji rinore, i rritur dhe edukuar në mjedisin e një familjeje dhe fshati me tradita atdhedashëse ai u vu në shërbim të qëndresës antifashiste qysh në fillimet e saj. Së bashku me shokët e tjerë të bërthamës, sidomos në vitet 1942-43, atë do ta gjejmë të plotësisht të përkushtuar ndaj detyrave të rinisë antifashiste duke punuar pa u lodhur për përhapjen e frymës për nevojën e rezistencës dhe zgjerimit të rradhëve të njësiteve të armatosura të Rrëzës së Korçës, frutet e së cilës do të dukeshin në ndërgjegjësimin e më se 300 të rijve që u rreshtuan në çetat dhe batalionet e armatosura në vitin 1942 dhe 1943. Në tetor '43 merr pjesë në formacionet e armatosura të UNÇI. Operacioni armik i Dimrit e gjeti në Br.IVs, ku si gjithë të tjerët iu desh të përballojë vështirësi të jashtëzakonshme të luftimeve, rraskapitjes, të të ftohtit, urisë e pagjumësisë. Në një betejë me focat naziste në Arzë të Devollit plagoset rrëndë. Mjekohet në Slimnicë të Greqisë në spitalin partizan të EAM-it, për t'u rikthyer mbas 3 muajsh në formacionet luftarake, tashmë në rradhët e Br. XVs, si zv.komisar kompanie deri në çlirim. Fluturaku i përballoi me nder të gjitha detyrat dhe vështirësitë e luftës për 3 vjet. Megjithatë i vdes i ati dhe Fluturaku ishte i vetmi mashkull madhor i familjes, ai nuk e braktisi luftën deri në fund, ku mori gradën n/toger dhe u nderua me një numër medaljesh e dekoratash. Fluturaku fliste me krenari për pjesëmarrjen në atë luftë, por nuk u pajtua kurrësisht me pasojat shkatërruese të Diktaturës Komuniste të E.Hoxhës mbas çlirimit, ku disa segmente të errëta e kishin zanafillën që nga koha e luftës. Si shumë të tjerë, përfshi dhe komunistë patriotë e idealistë, edhe Fluturaku ëndërronte një Shqipëri të pas luftës me mirëqenje, liri, demokraci, paqe dhe harmoni. Por këto mbetën vetëm dëshira humane. Thuajse menjëherë aristokracia e kuqe u distancua nga populli dhe luftëtarët e thjeshtë. Atyre nuk u mungonte asgjë në banesat luksoze me komfortet e grabitura nga viktimat e tyre, ndërsa partizanëve të thjeshtë, tashmë nëpër kazerma, shpesh u mungonte edhe buka thatë. Mbretëronte kështu një kaos i madh padrejtë-



sish por edhe krimesh, me apo pa gjyq. Servilët dhe spiunët filluan të ngjitin shkallët e karrierës, ndërsa të tjerë që e meritonin më shumë mbeteshin të papërfillur. Fluturaku ishte nga të parët që kuptoi shkëlqen e idealeve për të cilat u luftua dhe si guximtar dhe i ndershëm që ishte reagoi duke u shprehur haptazi në një mbledhje të oficerave, ku merrnin pjesë përfaqësues të KQ të P.Komuniste në verë të vitit 1946. Ai ishte i ndërgjegjshëm për pasojat që mund të kishte, por kurrë nuk mund besonte se puna do të shkonte deri aty sa ta arrestonin dhe ta dënonin si armik i popullit.

Me regji të agjentëve jugosllavë, për qëllime të caktuara politike, sigurimi i shtetit inskenoi goditjen masive të oficerëve të regjimentit të Delvinës, ku bënte pjesë dhe Fluturaku, nga të cilët rreth 30 u dënuan me vdekje. Fluturakun e arrestuan më 23 qershor 1947.

Gjashtë muaj në birucë ai provoi torturat më çnjerzore, shënjat e të cilave i dallohen edhe sot në trup. I kërkohet me insistim të firmoste një deklaratë, ku thuhet: "Unë Fluturak Vinçani (Asabella), i ngarkuar nga Grupi i Oficerëve Delvinë, me rastin më të parë do të shkoja në Tiranë dhe do t'i bëja atentat E.Hoxhës". Kuptohet se me këtë motivohej dënimi me vdekje, prandaj

ai nuk e firmosi kurrë këtë deklaratë. Së fundi bënë dhe këtë provë: M. Shehu dhe S. Xharo e morën me makinë, e çuan në breg të Lanës dhe i dhanë kazmë e lopatë të hapte varrin e tij, duke paralajmëruar se, po nuk pranonte akuzën, do ta pushkatonin aty. Filloi të hapë varrin dhe kur panë që edhe kështu nuk u përul, e masakruan me shkelma dhe e kthyen në birucë. E dënuan 8 vjet për "agjitacion e propagandë kundër regjimit", me argumentin se (gjoja) kështu kishin deponuar katër oficerat nga të Grupit, por që tashmë ishin të ekzekutuar. Me dënimin e Koci Xoxes në 1949 u lirua, por me gjithë përpjekjet e tija të vazhdueshme, si dhe shumë të tjerë, Fluturakun nuk e reabilituan kurrë.

Mbi 40 vjet do ta ndihej i "fyer" e i "poshtëruar" nga kalvari torturonjës prej persekutimit nga agjentët e Sigurimit famëkq, por ai asnjëherë nuk e lëkundti krenarinë dhe dinjitetin... I dërguan një ftesë në përvjetorin e 30-të të formimit të Br.XVs, ku kishte qënë pjesëmarrës dhe, disi i kënaqur, shkoi dhe u rreshtua me shokët e tjerë për ceremoninë e rastit; por pas pak shkuan tek ai agjentët e Sigurimit dhe e dëbuan duke e fyer publikisht me shprehjen: "Ti je armik dhe nuk meriton të rreshtohesh këtu!". Shumica e ish bashkëluftëtarëve u prekën nga ky trajtim, por fatkeqësisht pati dhe 2-3 të ndërsyer që e quajtën këtë një "qëndrim rrevolucionar!" Sidoqoftë ajo periudhë perëndoi si një ëndërr e keqe, por nga një pikëpamje, si shumë të tjerë, Fluturaku ngeli i zhgënjyer. Sepse ish persekutorët, jo vetëm nuk u ndëshkuan, jo vetëm nuk kërkuar falje asnjëherë, por veçse ankoheshin për trajtimin e tyre. Ndërkohë, shumë prej tyre, duke spekuluar me situatën tranzitore dhe duke shfytëzuar labirintet e fshehta të ish regjimit, u pasuruan me prona e kapitale, duke bërë një jetë shumë më të mirë se ish viktimat e tyre të dikurëshme, tashmë të braktisura e të harruara. Por Fluturaku nuk demoralizua nga këto. Edhe pse i lodhur nga mosha dhe tallazet e jetës, ai nuk rreshti së qeni një qytetar aktiv, duke kontribuar si Kryetar i OBVL-Korçë, në evidentimin dhe promovimin e vlerave patriotike e morale te popullit shqiptar. Veteranët e OBVL dhe pasardhësit e tyre e vlerësojnë lart Fluturakun dhe ndihen të nderuar që e kanë midis tyre. I urojmë mirësi në familje, jetë të gjatë dhe shëndet!

*Materiali për këtë dedikim u muarr nga kujtimet e bashkëthemeluesit dhe ish n/kryetarit të OBVL S.Vinçani, shok fëminie dhe bashkëluftëtar i Fluturakut

Kuvend përfaqësues i të gjithë shqiptarëve

(Vijon nga faqja 3)

e votimit në Luginën e Preshevës të cilën Komiteti i Helsinkit e ka quajtur spastrim etnik administrativ".

Në këtë kontekst foli edhe kryetari i Komunës së Preshevës, Shqiprim Arifi, theksoi se shqiptarët e Luginës së Preshevës ende përballen me diskriminim nga Beogradi dhe se presin prezencë më të madhe të qeverive të Shqipërisë dhe të Kosovës, sikurse edhe bashkëpunim me komunat shqiptare të rajonit. Ai tha se ndonëse situata për shumicën e vendeve shqiptare është shumë më e mirë se sa ajo e 144 vjetëve më parë, një gjë e tillë nuk vlen për Preshevën. -

"Fatkeqësisht ne nuk kemi një komunë normale. Në Maqedoni, komunat janë pjesë e shtetit i cili është pjesë e NATO-s. Në Shqipëri kemi ecur shumë më larg. Në Kosovë jemi në një shtet të lirë, kurse në Preshevë është ndryshe. Diskriminimi të cilin ju e keni përjetuar viteve nëntëdhjeta, ne e përjetojmë ende. Nuk kemi investime nga qendra. Punësimin e kombësisë serbe nëpër strukturat

shtetërore brenda Luginës së Preshevës e kemi ashtu qysh ka qënë në Kosovë sidomos në vitet 90-ta", u shpreh kryetari i komunës së Preshevës. Arifi kërkoi që Presheva të mos shihet vetëm si jetime, por si pjesë e kombësisë shqiptare, duke kërkuar vizita të njëpasnjëshme nga liderët e komunave shqiptare.

Ndërsa, kryetari i Komunës së Tetovës, Bilall Hasami tha se po angazhohen për ndërtimin e rrugës Prizren -Tetovë qe sipas tij do te ishte një lidhje tjetër që do të bashkoj shqiptarët dhe do të fuqizoj këmbimin në mes të dy qyteteve në frymën e vëllazërimit dhe vlerave europiane.

Pa Lidhjen e Prizrenit rrjedha e historisë sonë kombëtare nuk do të ishte e njëjtë. Nuk do të kishim 28 nëntorin e vitit 1912, nuk do të kishim Luftën Antifashiste Nacionalëlimtare, lëvizjen kombëtare për çlirimin e Kosovës e cila arriti kulminacionin historik me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe me shpalljen e pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008. thanë shumë pjesëmarrës në këtë manifestim madhështorë.

LIBRI

Disa të pathëna për mitin e “Shtabit Ndërbalkanik” gjatë Luftës së Dytë Botërore

Midis shumë diskutimeve të tjera, në të kaluarën, një temë mjaft e përfolur për një aspekt të veçantë të LANÇ ka qënë dhe çështja e “Shtabit Ballkanik, apo Ndërbalkanik”. Për të ndriçuar sadopak këtë pjesë të historisë po paraqesim disa të dhëna të shkëputura nga libri “Vinçanët”, me autorë S.Vinçani dhe Albert Kotini, shkruar sipas kujtimeve të njërit prej dëshmitarëve okularë të një prej takimeve të ndodhura për këtë temë. Bëhet fjalë për Gjeneral Nexhip Vinçanin “Nderi i Kombit”, ish Komandanti i Shtabit të UNÇI të Qarkut të Korçës, në atë kohë.

E VËRTETA E SHTABIT NDËRBALLKANIK.

•“Sikurse del edhe nga ato që shkruan E.Hoxha në “Titistët”, misionarët e Titos në atë kohë kishin hyrë e dalë në Shqipëri dhe kishin zhvilluar bisedime me Enverin. Ata, me se duket, u sillnin mesazhe dhe detyra Miladin Popoviçit e Dushan Mugoshës, por edhe direkt E.Hoxhës. Një nga këta misionarë, që hyri e doli disa herë në vitin 1943 në Shqipëri, ishte Vukmanoviç Tempo. Për kohën që E.Hoxha ka qënë në qarkun e Korçës, dy herë vetëm gjatë muajit Qershor, ka ardhur Tempo në takim me të. Herën e parë, mesa mbaj mend, ka qënë aty nga dhjetëditëshi i parë i muajit Qershor. Tempon së bashku me Milicën, disa shoqërues të njësitit të Korçës i sollën në Vinçan, me një porosi nga Komiteti Qarkor i Korçës, që të merreshin masa të veçanta për sigurimin e tyre dhe që vetë Samiu (ish sekretar i Celulës së Rrëzës) t’i shoqëronte për në Kucakë. Të nesërmen, Samiu (vëlla i Nexhipit), së bashku dhe me tre shokë të tjerë i shoqëruan për në Kucakë. Bisedat dhe misioni i tyre atje nuk dihen, por nga ngjarjet e mëvonëshme dhe shkrimet e E.Hoxhës tek “Titistët”, tema e bisedimeve (të paktën kryesore) duket se ka qënë në lidhje me “Shtabin Ndërbalkanik” (Maqedonisë, Greqisë dhe Shqipërisë)... Disa ditë, para se të nisesha për në Kuqar-Përmet, m’u kërkua nga E. Hoxha mendimi se në cilin vend mund të bënim një takim me përfaqësues nga këto tre vende; Jugosllavisë (Maqedonisë), EAM-it të Greqisë dhe Shqipërisë. Për arsyen se do të kishim mysafirë të huaj, së pari duheshin marrë masa që të mos ndodhte ndonjë incident, së dyti “vendi” nuk duhej të ishte shumë në thellësi, për shkak të vështirësive për pjesëmarrësit. Ofrova shtëpinë time në Vinçan, duke e siguruar se pavarësisht largësisë së vogël nga Korça (7 km), kishim mundësinë të merrnim masa të plota sigurimi e pune. Pas disa ditësh, u zhvillua mbledhja për të cilën fola më sipër. Nga Jugosllavët, përveç Tempos e Miladinit, ishin dhe dy përfaqësues të Shtabit të Ushtërisë NÇI. të Maqedonisë, gjithash-



tu dhe dy përfaqësues të EAM-it Grek. Nga ana jonë merte pjesë: E.Hoxha, K.Xoxe, K.Themelko, P.Kristo dhe unë. Bisedimet zhvilloheshin në frëngjisht dhe zgjatën tre ditë. Dihet historikisht se nuk u muar asnjë vendim për krijimin e këtij “Shtabi Ndërbalkanik”. Shkaktarë për mosarritjen e kësaj marrëveshje ishin përfaqësuesit e EAM-it Grek, të cilët mbronin tezën se: “Nuk kishin një mandat të tillë, mbasi problemi është kompleks dhe ka të bëjë me mardhënie ndërshtetërore”; ndërsa u ra dakort për bashkëpunim e ndihmë të ndërsjellë në brezin kufitar, por me kusht që “nëse do ta lypë nevoja të kalohet në territorin e vendit fqinj, të përdoret flamuri Kombëtar i atij vendi dhe të respektohet pushteti NÇI. i vendit”. Mbi këto baza, mesa më kujtohet, u arrit marrëveshja dhe patëm raste bashkëpunimi si me maqedonasit ashtu dhe me grekët, sidomos gjatë operacioneve ushtarake lokale që bënin pushtuesit, ashtu dhe për shtrimin e të plagosurve në vendmjekimet e afërta... Polemika, mesa dimë, ndërmjet përfaqësuesit Jugosllav Vukmanoviç Tempo dhe E. Hoxhës, disa dekada më vonë, ka të bëjë me çështjen

sipas së cilës: “Kjo marrëveshje, që kishte si qëllim nënshtrimin ndaj Jugosllavisë Titiste të Shqipërisë dhe Greqisë, nuk u miratua sepse atë e kundërshtoi Enver Hoxha!”. Kurse në një libër që ka shkruar Tempo, përkundër kësaj që pretendon Hoxha, ai përmend punën e një fletoreje shënimesh, ku vërtetohet e kundërta asaj që thotë Enveri. Me fjalë të tjera, E. Hoxha ka qënë dakort për këtë “Shtab”. Me që kam qënë i pranishëm, mbaj mend që as Enveri e as Koçi nuk u shprehën kundër. Mandej për këta të dy kjo nuk ishte një kërkesë, si të themi, e “befasishme”; mbasi të paktën Tempo kishte qënë tre herë brenda dy muajve në takim me Enverin e sigurisht dhe me Koçin. Do të mendoja që vetë pranimi i tyre për ta diskutuar këtë, tregon që nuk ishin kundër, për ndryshe kjo çështje do të ishte mbyllur me kohë... Njëpërmjet disa pyetjeve unë shtriva çështjen e vështirësive që paraqiste mekanizmi i këtij problemi, sepse krijonte një precedent të tillë ku do egzistojnë dy komanda, të cilat të pavarura njëra nga tjetra, krijojnë një vartësi të dyfishtë. Vjen fjala, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtërisë Shqiptare planifikon një operacion ushtarak, kurse “Shtabi i përbashkët ndërbalkanik” në të njëjtën kohë, planizon nga ana e tij një tjetër plan, në një territor të vendit fqinj, etj. Shprehja mendimin që të ketë bashkëpunim për aksione të veçanta, por jo me karakter të përherëshëm. Në “fletoren e shënimeve” E.Hoxha sigurisht ka diskutimet, propozimet edhe mendimet e pjesëmarrësve; ndër to dhe të vetat. Këtë fletore e di që e mori Tempo duke i thënë Hoxhës se: “Po e marr që të plotësoj shënimet e mia, mbasi ti i ke mbajtur më të rregullta, e ta kthej prap”. Mu desh tu përkthej nga frëngjishtja kolegëve tanë, sepse E.Hoxha i mbajti vetë shënimet, si të thuash “protokollin”, dhe gjatë kohës që përkthenim nga njëra gjuhë në tjetrën, ai kishte mundësi e kohë, t’i pasqyronte më mirë mendimet që u shprehën aty...

Në shtëpi atëhere, bashkë me shoqëruesat bëheshin 17 veta, por kjo nuk përbente ndonjë problem. Ne kishim në atë kohë të pa djegura 2 shtëpitë. Vetëm në atë më të madhen ishin 7 dhoma të mira pune e pushimi. Në fund të gjithë u shprehën të kënaqur për kushtet e punës, pushimit, ushqimit dhe masave të sigurimit që ishin të nivelit të lartë”.



PROMOVIMI

“Akademik”, titull i merituar për shkrimtarin dhe publicistin Halil Rama

Në promovimin e librit të 20-të “Magjia e fjalës”, vlerësohet nga Akademia Shqiptaro-amerikane e Shkencave dhe Arteve, me seli në Nju Jork-SHBA

Nga Eglantina ALLIAJ

Pasi ka marrë më parë titullin “Mjeshtër i Madh” nga Presidenti i Republikës (Dekret Nr.11724, datë 17.09.2020), avokat (Licensë nr.7979, datë 31.10.2014) dhe “Ambasador për paqe” (Dhënë nga Federata Botërore e Paqes Universale), shkrimtari dhe publicisti i njohur Halil Rama, më 21 qershor përjetoj emocionin e marrjes së titullit “akademik”, dhënë nga Bordi i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në Nju Jork-SHBA.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast në Bibliotekën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, me praninë e më shumë se 50 personaliteve akademike, të letrave, artit e kulturës, Kryetari i Akademisë Shqiptaro-Amerikane të Shkencave dhe Arteve me qendër në Nju Jork, Prof. Dr.Skënder Kodra, ndërsa i ka dhënë Certifikatën e anëtarësimit dhe të titullit “akademik” ka vlerësuar veprën shumëdimensionale të Halil Ramës, të identifikuar në 20 libra të botuar prej tij në harkun kohor të dy dekadave, të mirëpritura nga lexuesi dhe të promovuara bujshëm, si edhe gjashtë dokumentarët televizivë që mbajnë autorësinë e tij.

HALIL RAMA I KA DHËNË SHOQËRISË VLERA CILËSORE KRIJUESE NË DISA ZHANRE NJË-KOHËSISHT

Mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e z.Halil Rama foli akademik Fatos Daci, botues i gazetës “DIBRA”. Publicisti dhe shkrimtari i mirënjohur Daci që moderoi mjeshtërisht këtë event, ndër të tjera tha se “Tashmë, Halil Rama është aktor dhe faktor i vlerësuar në fushën e gazetarisë dhe të monografisë, ku nuk është rastësor, ku nuk është kalimtar, pasi me dekada, në vijimësi, ka qenë dhe është një zë i fuqishëm dhe i afirmuar, duke i dhënë shoqërisë vlera cilësore krijuese në disa zhanre njëkohësisht”. E rëndësishme, sipas tij, është se, në gazetari, nuk ka kryer detyra të dorës së dytë e të tretë, apo të korrespondentit e kronikanit të thjeshtë, pasi ka kryer detyrën e gazetarit-redaktorit në dy nga gazetatat më të mëdha ditore të vendit dhe detyrën e kryeredaktorit e të drejtorit në 5 (pesë) gazeta të tjera periodike, punë që aktualisht e kryen edhe sot.

“Mjeshtri i Madh Halil Rama është qëmtues i hollë i ngjarjeve e fenomeneve shoqërore dhe politike, kërkues i palodhur i personazheve të tij, të cilët mbartin vlera përgjithëse, shoqërisht të dobishme. Personazhet e këtij autori, asnjëherë nuk kanë qenë rastësor dhe të çfarëdoshëm, por janë të përzgjedhur dhe me vlera e kontribute në fushat e tyre”, tha botuesi i gazetës “Dibra” Fatos Daci. Kjo sipas tij për faktin se Halil Rama ka lëvruar me sukses, si shkrimtar, edhe fushën e monografive historike për fshatra, krahina dhe personazhe. Deri më tani, ka shkruar e botuar 20 monografi, që të gjitha të mirërealizuara dhe me vlera ideo-artistike, të cilat kanë përcjellë te lexuesi i shumë vlera të padiskutueshme letrare, historike e shoqërore.



NË SHËRBIM TË LIBRIT NË GJUHËN SHQIPE

Për librin “Magjia e fjalës” botim i UET PRESS (Universiteti European i Tiranës), foli poeti, prozatori, analisti dhe politologu Preç Zogaj, i cili ka bërë dhe parathënien e këtij libri. Ndër të tjera Zogaj tha se “Të lexuarit për Halilin nuk mbetet në kuadrin e nevojave dhe kënaqësive individuale. Duke hedhur në letër e botuar rregullisht vështrimet e tij për librat që pëlqen, ai vëhet në rolin e ndërmjetësit special mes librit dhe lexuesve. Merr kështu rolin e një shërbyesi publik, që ndërsa nuk ekziston në nomenklaturën zyrtare të funksioneve, i përgjigjet një kredoje më të lartë që përcakton vendin e intelektualit në shoqëri”. Sipas poetit, prozatorit, esseistit e analistit të mirënjohur Zogaj, “Magjia e fjalës”, përveçse një adresar titujsh për t’u lexuar dhe një koleksion citimesh që në lidhjen e tyre krijojnë një buqetë perlash për njohjen dhe kujtesën, është një shërbesë e madhe letrare dhe intelektuale në këto kohë të vështira për artin dhe

kulturën. Nëse do të përfytyronim një “Urdhër” për mbrojtjen dhe promovimin e kulturës si pasuri e shoqërisë dhe njerëzimit, Halil Rama është aty në shërbim të librit në gjuhën shqipe.

Duke vijuar në të njëjtën linjë, prof. Bujar Kapexhiu - Nderi i Kombit vlerësoi krijimtarinë rezultative të Halil Ramës, në arsenalin krijues të të cilit tashmë janë 20 vepra mjaftë cilësore, që nga monografitë “Një filozof popullor në oborrin mbretëror” (kushtuar mendimtarit dhe patriotit dibran Dine Hoxha), e “Muharrem Xhediku-kompozitori i tangos shqiptare”, “Rrahman Parllaku-një legjendë në kufirin e dy kohëve”, “Muhurri-histori dhe personalitete”, e deri tek më e fundit “AND-ja e pandryshuar e Shefki Karadaku, botuar dhe promovuar vetëm para disa ditësh.

“PËR HALIL RAMËN, E PARA ËSHTË SHQIPËRIA”

Mbresëlënese që për pjesëmarrësit edhe fjala e shkrimtarit Shpendi Topollaj, i cili ndër të tjera tha se “Me shkrimet e tij për njerëzit që lanë gjurmë të pashlyera në fatet e krahinës apo atdheut, një intelektual i përkushtuar, i kulturuar dhe i ndershëm si Halili, qoftë edhe me ngjyrimet letrare, ka dhënë ndihmesën e tij në saktësimin e historisë.

Krijimtaria e tij me përmasa shkencore, si në gazeta ashtu edhe në librat e tij monografikë, me shembujt që ai ka zgjedhur dhe analizuar, është njëkohësisht edhe një kontribut i çmuar në rritjen e ndjenjës së dashurisë për vendin tënd, krenarinë për qenien shqiptar, përpjekjet për bashkim kombëtar, i prijes për ta respektuar tjetrin si vëlla, i largimit të urrejtjes e përçarjes, dhe sidomos i besimit të palëkundur se Shqipërinë do ta bëjmë ne dhe vetëm ne, e jo të huajt, kushdo qofshin ata”.

Kadri Tarelli, një tjetër shkrimtar i njohur nga Durrësi e vlerësoi Halil Ramën si një personalitet që nuk resht të dojë dhe nderojë mëmëdheun. “Personalisht jam takuar rrallë, por kam



njohur një pjesë të mirë të krijimtarisë së tij letrare e publicistike, dhe ca më shumë ç’kanë thënë të tjerët për të, ku përfshihen pena të njohura të letrave shqipe. Besoj se të bëhesh personazh i ajkës letrare kombëtare, është nderim dhe lakmi për të gjithë krijuesit”,-tha Z.Tarelli. Një gjykim i shpejtuar, por jo i nxituar, e shtyn ta shtrijdh mendimin se: Në të gjithë prodhimtarin e tij intelektuale, që dikush e quan, “Testament i vyer historiko-kulturor”, dominon atdhedashuria, si kumti më i qenësishëm për çdo shqiptar. Fjalja e, shkurtër se, “Atdheu fillon nga familja”, në mënyrë lakonike flet shumë, duke jetësuar një fjalë të urtë Amerikane, që thotë: “Dashuria e madhe për atdheun, lind nga dashuritë e vogla për vendlindjen”. Të gjitha më çojnë në mendimin logjik, se “Për Halil Ramën, e para është Shqipëria”.

Vlerat publicistike, letrare e qytetare të akademik Halil Rama, Mjeshtër i Madh, u shpallën para pjesëmarrësve dhe nga: akademik Arjan Hamiti, prof.dr. Bernard Zotaj, prof dr. Ylber Bezo-President i Kolegjit Universitar të Biznesit, prof. Shefqet Hoxha, prof.Jashar Demiri, Gjinovefa Kadriu -Këshilltare e kryebashkiakut Veliqaj, Bashkim Lami-kryetar i shoqatës “Bulqiza”, inxh.Munir Hoxha, akademik Xhelal Marku etj.

Ndër të tjerë, të pranishëm ishin edhe poeti, shkrimtari dhe politikani Besnik Mustafaj, Presidenti i këshillit Atlantik të Shqipërisë, Dr.Arian Starova, gjeneral Piro Ahmetaj, Mjeshtri i Madh Faik Bruçi, Muharrem Gjo-ka-Mjeshtër i Madh, nënkryetar i Organizatës së Bashkuar të Veteranëve, shkrimtari dhe poeti Sakip Cami, botuesi Bujar Karoshi, gazetari i njohur Dëfrim Karahasani, poeti Demir Rusi, biznesmeni Astrit Kuçi etj.

Kësisoj, Halil Rama ndau me miqtë, kolegët dhe personalitete e krijimtarisë letrare e publicistike në vend dy gëzime: përuroi librin e 20-të “Magjia e fjalës” dhe mori titullin “akademik” nga Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe Arteve, me seli në Nju Jork - SHBA.

FJALA

Krijimtaria e Halil Ramës është me përmasa shkencore, si në gazeta ashtu edhe në librat e tij monografikë

Zëri i ndërgjegjes

SHPENDI TOPOLLAJ

Është e çuditshme, por ja që shpesh ngjet që emri sikur parathotë se çfarë do të jetë njeriu gjatë gjithë jetës. Edhe emri i Mjeshtër të Madh, gazetari dhe shkrimtari Halil Rama, që nga arabishtja do të thotë “mik besnik”, sikur e vërteton këtë. I lindur në Muhurr, ku më ka mbetur mendja jo vetëm te hallva e papërsëritshme me të dy llojet e miellit, por edhe te ëmbëlsia me të cilën banorët e asaj treve dinin të prisnin mikun, Halili u mburrte me cilësitë dhe virtytet më të larta njerëzore dhe diti t'i ruajë ato të paprekura edhe kur erdhi për të jetuar dhe punuar në Tiranë. Në profesionin interesant dhe të vështirë të gazetarit, ai ka rrezatuar vetëm mirësi për të tjerët, aq sa padashur, sa herë e lexoja, më vinin ndërmend fjalët e filozofit francez të shek. 19 - të Victor Causin - it për xhironidin Kondorse (Condorcet), se “Dashuria për njerëzimin gjallon dhe zbukuron çdo faqe të shkrimeve të tij”. Nobelistja bjelloruse e vitit 2015, e lindur në Stanislav të Ukrainës, Svetlana Aleksievich (S. Alexandrovna Alexievich), te “Lufta nuk ka fytyrë gruaje” ka shkruar “Jeta njerëzore bëhet histori dhe historia copëzohej në mijëra jetë njerëzish”. Dhe ja ashtu, dashur padashur, me shkrimet e tij për njerëzit që lanë gjurmë të pashlyera në fatet e krahinës apo atdheut, një intelektual i përkushtuar, i kulturuar dhe i ndershëm si Halili, qoftë edhe me ngjyrimet letrare, ka dhënë ndihmesën e tij në saktësimin e historisë. Krijimtaria e tij me përmasa shkencore, si në gazeta ashtu edhe në librat e tij monografikë, me shembujt që ai ka zgjedhur dhe analizuar, është njëkohësisht edhe një kontribut i çmuar në rritjen e ndjenjës së dashurisë për vendin tënd, krenarinë për qenien shqiptar, përpjekjet për bashkim kombëtar, i prires për ta respektuar tjetrin si vëlla, i largimit të urrejtjes e përçarjes, dhe sidomos i besimit të palëkundur se Shqipërinë do ta bëjmë ne dhe vetëm ne, e jo të huajt, kushdo qofshin ata. Qysh në kohën e tij Justin Godart thosh se “Shqipërisë nuk i mungojnë njerëzit e aftë, por një kulturë e përbashkët. Prandaj i duhet këshilluar bashkimi dhe kujdesi”. Dhe pikërisht këtë bashkim dhe kujdes ka synuar edhe Halil Rama me artikujt e tij dhe ato që ka botuar në faqet e gazetës që drejton. E bën këtë në një kohë jo shumë të volitshme; kur shumë nga kolegët e tij, thjesht për meskitin apo interesat kalimtare politike, vjellin vrrer, dhe duke nxjerrë inatet apo qejfmbetjet e tyre me shkumë të helmatisur nga goja, kultivojnë urrejtje e ndasi krejt të panevojshme. Ne jemi dëshmitarë të broçkullave që ata na servirin, se do shihni se ç' do ndodhë, se FBI - ja do sjellë nja dy agentë që do bëjnë arrestime të bujshme, se Putini do shtypë butonin e bombës atomike e deri se së shpejti do fillojë Lufta e Tretë Botërore. Këta quaji si të duash, në daç vagabondë, në daç aventurierë e në daç të shitur, je brenda. Kurse Halil Rama është antipodi i tyre. Ata ndihen inferior ndaj tij, aqsa askush nuk ka guxuar ta kundërshtojë apo të përfshihet në debat me të. Dhe e gjithë kjo, se



ai vë mbi të gjitha shpirtin e tij në ato që thotë, vë llogjikën e nevojës madhore, dhe forcën e pakundërshtueshme të faktit. Në gjithë punën e tij ai është udhëhequr nga zëri i ndërgjegjes së vet dhe shembulli i atyre intelektualëve apo gazetarëve që luftuan për një Shqipëri të lirë, të pavarur, sovranë e mbi të gjitha, demokratike. Përmenda më sipër përpjekjet për bashkim kombëtar, dhe nuk mund të rri pa thënë se jo më larg se dje i pamë dy qeveritë shqiptare të takohen në Prishtinë, njësoj si të ishte Kosova një shtet i matanë oqeanit. Këtu, në mes të udhës na ka lënë politika ndërkombëtare, e cila duhet pranuar pa drojë se

po luan me ne. Kurse Halil Rama, qoftë si drejtues i gazetës “Veterani”, qoftë si një nga drejtuesit kryesorë të OBVL - së, ka shkruar përpara: ai ka realizuar bashkëpunim të pandërprerë me veteranët e Kosovës, me luftëtarët e UÇK - së, ka ndriçuar ngjarje të errësuar qëllimisht, dhe ka thënë të vërtetën për figura kryesore të luftës antifashiste që u ndëshkuan rëndë, vetëm pse kërkohnin bashkimin e trojeve tona. Shembujt janë të shumtë: qysh nga kujdesi për botimin e veprës së atdhetarit të shquar, Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit Rrahman Parllaku që Kosovën e kishte aq për zemër e deri te filmi dokumen-

- Halil Rama, qoftë si drejtues i gazetës “Veterani”, qoftë si një nga drejtuesit kryesorë të OBVL - së, ka shkruar përpara: ai ka realizuar bashkëpunim të pandërprerë me veteranët e Kosovës, me luftëtarët e UÇK - së, ka ndriçuar ngjarje të errësuar qëllimisht, dhe ka thënë të vërtetën për figura kryesore të luftës antifashiste që u ndëshkuan rëndë, vetëm pse kërkohnin bashkimin e trojeve tona. Shembujt janë të shumtë: qysh nga kujdesi për botimin e veprës së atdhetarit të shquar, Heroit të Popullit dhe Nderit të Kombit Rrahman Parllaku që Kosovën e kishte aq për zemër e deri te filmi dokumentar kushtuar jetës dhe veprës së Fadil Hoxhës

tar kushtuar jetës dhe veprës së Fadil Hoxhës. I cekta shkurtimisht këto, për të thënë se sa drejtë ka vepruar kryesia e Akademisë Shqiptaro - Amerikane kur ka zgjedhur pikërisht një njeri, një intelektual, një veprimtar dhe një patriot si Halil Rama për t'i akorduar titullin “Akademik”. I nderuar zoti kryetar Prof. dr. Skënder Kodra, lejoni mëni t'u them se me të tillë burra, ju i bëni akoma më shumë nder edhe vetë asaj Akademie e cila në çdo hap e ka në mendje dhe zemër Shqipërinë dhe shqiptarët kudo që janë. Për më tepër që ai është gazetar, për të cilët Vinji është shprehur aq bukur, duke thënë se “As teologët që predikojnë në kishë, as oratorët në parlament, as profesorët në shkollë nuk kanë aq ndikim sa shtypi”.

“HALIL RAMA, PERSONALITET QË NUK RESHT TË DOJË DHE NDEROJË MËMËDHEUN”

Kadri TARELLI*

Kam kënaqësinë të them pak fjalë për mikun tonë Z. Halil Rama, “heroi” i këtij kuvendi kaq të bukur, i mbledhur për një vlerësim kaq të lartë, për pranimin si anëtar i Akademisë Shqiptaro - Amerikane. Është nder dhe vlerësim i merituar për këtë personalitet të njohur në letrat shqipe, që mban titullin “Mjeshtër i madh”, si shkrimtar, poet, studiues, publicist, njëkohësisht edhe veprimtar shoqëror.

Që në kryefjalë të këtij shkrimi të shkurtër, po them: “Halil Rama, është personalitet që nuk resht të dojë dhe nderojë mëmëdheun”.

Personalisht jam takuar rrallë, por kam njohur një pjesë të mirë të krijimtarisë së tij letrare e publicistike, dhe ca më shumë ç'kanë thënë të tjerët për të, ku përfshihen pena të njohura të letrave shqipe. Besoj se të bëhesh personazh i ajkës letrare kombëtare, është nderim dhe lakmi për të gjithë krijuesit.

Një gjykim i shpejtuar, por jo i nxituar, më shtyn ta shtrydh mendimin: Në të gjithë prodhimtarin e tij intelektual, që dikush e quan, “Testament i vyer historiko-kulturor”, dominon atdhedashuria, si kumti më i qenësishëm për çdo shqiptar. Fjalja e, shkurtër se, “Atdheu fillon nga familja”, në mënyrë lakonike flet shumë, duke jetësuar një fjalë të urtë Amerikane, që thotë: “Dashuria e madhe për atdheun, lind nga dashuritë e vogla për vendlindjen”. Të gjitha më



çojnë në mendimin logjik, se “Për Halil Ramën, e para është Shqipëria”.

Ajo që sërish më duhet të nënvizoj, është: Në të gjithë jetën e tij në krijimtarinë, kurrë nuk mund të gjesh, qoftë edhe një rresht të vetëm që të mbjellë përçarje. Jam i bindur, se kjo përbën një pasuri shpirtërore dhe intelektuale me shumë vlera, si qytetar e atdhetar. I lumtur ai që zotëron një pasuri të tillë shqiptare. Unë e quaj, si gjëja më e bukur, madje e shenjtë për çdo shqiptar, që e nd-

jen dhimbjen brenda lëkurës së tij, se të gjitha prapësitë e këtij vendi, na vijnë nga përçarja që kemi mes vedit. Halili e ndjen se kjo është një plagë e hapur, ndaj unë po guxoj të them, se përmendore sa mali i Dajtit do t'i ngrihet atij që merr përsipër dhe realizon pajtimin kombëtar. E gjitha shkon në një udhë me porosinë e Presidentit Xhon Kenedi, që thoshte: “Mos pyet se çka mund të bëjë vendi yt për ty, por pyet se çka mund të bësh ti për vendin tënd”.

I nderuar Miku ynë Halil Rama, në fund më lejo të citoj, Ata Turk, Mustafa Qemalin, që shprehej: “Në jetën tënde, ti ndoshta ke dashuruar. Por a e ke provuar të të duan të tjerët? Kjo është një kënaqësi që nuk e ka shqen në botë. E sidomos kur të do populli. Më lini ta shijoj edhe disa çaste këtë kënaqësi”. Jam i bindur se të pëlqen të shtoj pa frikë edhe dy fjalë nga vetja ime: Miku ynë, ke edhe shumë vite të shijosh këtë kënaqësi, të cilën do ta pasqyrosh dhe do ta rrëmbesh në shumë libra të tjerë. Sot janë 20 duke shpresuar se 40 do të jenë pak.

Në fund, kam dëshirë të dëgjoj thirrjen që Euripidi na sjell nga lashtësia: “O njeri! Kurrë mos u lodh për ndihmën që i jep atdheut!

Urime! Jetë të gjatë dhe nderim paç ndër vite. Vlerësimi yt, na gëzon dhe na nderon të gjithëve.

*Përhëndetjet në ceremoninë e dhënies së titullit “akademik” dhe promovimin e librit “Magjia e Fjalës” - 21. Qershor, 2022.

FOTOREPORTAZH

Akademia Shqiptaro-Amerikane e Shkencave dhe Arteve vlerëson kontributin e Sekretarit të Përgjithshëm të OBVL

HALIL RAMA MERR TITULLIN "AKADEMIK" dhe promovon librin "MAGJIA E FJALËS"

